

## **Sistemi i i pikëzimit për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve:**

1. Në fazën e parë bëhet vlerësimi me pikë duke ju referuar rezultateve të shkollimit për çdo diplomë që zoteron kandidati, eksperiencës në mësimdhënie, aktivitetit shkencor, studimeve të ciklit të tretë, gradës shkencore dhe titujve akademikë si më poshtë:  
Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL në Shqipëri:
  - Për diplomën “Bachelor” 0,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9 -10.
  - Për diplomën “4-vjeçare” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
  - Për diplomën “5-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
  - Për diplomën “Master i Shkencave” apo “Master i Nivelit të Dytë” 0.5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
2. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë të fituar në universitetet perëndimore:
  - Për diplomën “Bachelor” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
  - Për diplomën “4-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
  - Për diplomën “5-vjeçare” 1,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
  - Për diplomën “Master i Shkencave” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
3. Eksperienca në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:
  - Me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 5 pikë në total.
  - Me kohë të pjesshme 0,5 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 2 pikë në total.
4. Aktiviteti shkencor:
  - Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti 5 pikë çdo artikull.
  - Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial 2 pikë çdo artikull.
5. Në fazën e dytë, bëhet vlerësimi me pikë duke iu referuar intervistës me gojë e cila vlerësohet në intervalin nga 1-10 pikë.